



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 2706 Prot.

Shijak, më 19.05.2026

NJOFTIM PUBLIK

Në bazë të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar, VKM nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfitur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM, nr. 852, datë 26.12.2024 “Për procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit për përfitimin nga programet e strehimit social”, VKB nr 48 datë 26.11.2025 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit dhe dokumentacionit që duhet të plotësojnë individët/familjet që të plotësojnë nga progarimi i banesave me kosto të ulët”, VKB nr 46 datw 23.12.2024 ‘Për miratimin në parim për përdorimin e banesave të lira të ndërtuara, nga programi i zhvillimit të zonave të reja në ndërtesat më njësi banimi (pallat), për qëllime stehimi” ;

JU INFORMOJMË SE:

Hapen aplikimet për programin social të strehimit “Në programin banesa me kosto të ulët”, të banesave të lira të ndërtuara nga programi i zhvillimit të zonave të reja në ndërtesat me njësi banimi (pallat)”.

Njoftojmë të gjithë qytetarët e interesuar të Bashkisë Shijak për t’u trajtuar me strehim, se duke filluar nga data **19.05.2026** , fillojnë aplikimet për të përfitur nga programi social i strehimit “Banesa me Kosto të Ulët”.

Aplikimet do të kryhen online në portalin qeveritar E-Albania dhe do të jenë të hapura deri me datë **19.06.2026**.

Kushtet, procedurat dhe dokumentacioni për të përfitur nga programet sociale të strehimit janë:

Në zbatim të VKM-së nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfitur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, përcaktohen kriteret dhe procedurat për të përfitur strehim sipas çdo program.

Kushtet që duhen plotësuar për të përfitur nga Programi “Banesa me kosto te ulet” janë:

Të jetë banor i Bashkisë Shijak ;
Të ketë mbushur moshën 18 vjeç;

Të mos ketë/disponojë banesë në pronësi ose të zotërojë një sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, sipas përcaktimeve ligjore ose ka mbetur i pastrehë për shkaqe të përcaktuara në ligj; Ka të ardhura të pamjaftueshme për të përballuar pagesat e kredisë që ofrohen nga institucionet financiare.

Procedurat për të përfituar nga programet sociale të strehimit janë:

Faza e parë:

Në fazën e parë aplikantët paraqesin kërkesën e tyre për të përfituar nga ky program, sipas ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar. Përfshirja në programet sociale të strehimit bëhet nëpërmjet paraqitjes së kërkesës on-line në portalin unik qeveritar "e-Albania" /nëpërmjet strukturës përgjegjëse për strehimin të njësisë së vetëqeverisjes vendore të vendbanimit të aplikantit.

Faza e dytë:

Në fazën e dytë të aplikimit përfshihen vetëm ata individë/familje që plotësojnë kushtet për t'u trajtuar me këtë program.

Familjet që rezultojnë të përzgjedhura nga faza e parë e aplikimit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga momenti i njoftimit nga Struktura përgjegjëse e Strehimit (Komisioni për strehimin social) , paraqesin nëpërmjet platformës e-albania në dritaren "Kërkesa për programet sociale të strehimit social" , dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në vendimin nr. 384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore"

Struktura përgjegjëse për strehimin në bashki klasifikon kërkesat sipas sistemit të pikëzimit, të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak dhe realizon shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga çdo aplikues, si dhe në vijim dërgon për vlerësim dhe shqyrtim të mëtejshëm pranë Komisionit të Strehimit.

Pas vlerësimit dhe shqyrtimit nga Komisioni i Strehimit, struktura përgjegjëse për strehimin në bashki dërgon për miratim në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, listën e përfituesve për secilin program social të strehimit që zbaton.

Çdo aplikues që nuk ka përmbushur kriteret për të qenë pjesë e listës përfituese, njoftohet nga struktura përgjegjëse për strehimin në bashki dhe mund të paraqesë ankim pranë bashkisë Shijak .

Lista e dokumentacionit të nevojshëm është:

Për të dhënat personale:

- Çertifikata e lindjes së aplikantit/ certifikatë personale/(gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania); kopje kartë identiteti
- Vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetqeverisjes vendore, ku kërkohet strehim social, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit;

Për vërtetimin e kushteve të banimit:

- Vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) për pronat që disponohen ose jo në emër të secilit anëtar madhor të familjes (për të gjithë territorin e Shqipërisë)(gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania);
- Vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për secilin nga anëtarët madhorë të familjes që nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën në 5 vitet e fundit, përveç rastit kur pronësia mbi to ka humbur për shkak të forcës madhore. (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania);
- Vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) për sipërfaqen e pronës që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat në fuqi të strehimit (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania);
- Vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) të vendit të origjinës se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret për strehim, për çdo anëtar madhor të familjes, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;
- Akt-verifikimi nga Bashkia për:
 - Banesat në rrezik shembjeje;
 - Rastet kur familja ka mbetur e pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore;
 - Banesat që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit;
 - Vendim i gjykatës për familjet që humbasin banesën për shkak të zbatimit të vendimit të gjykatës;
- Akt-verifikimi nga struktura përgjegjëse për strehimin në bashki për familjet e minoritet kombëtar Rom dhe Egjiptian, që banojnë në banesa individuale ose struktura, që nuk klasifikohen si banesë.

Për vërtetimin e kushteve familjare:

Çertifikatë familjare (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania);

- Vendim i gjykatës, që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara. Për vërtetimin e kushteve sociale:
- Vërtetim i Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë së Kufizuar (KMCAP), për individë me aftësi ndryshe,
- Vërtetim përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezën e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar, për individët me statusin e jetimit;
- Dokument që vërteton që ka mbetur i pastrehë si rezultat i lirimimit të banesave, ish-pronë e subjekteve të shpronësuara;
- Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin “emigrant”, “punëtor emigrant” dhe “azilkërkues”;
- Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve;

- Vërtetim nga Policia e Shtetit;
- Vërtetim nga Garda e Republikës;
- Vërtetim nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm;
- Vërtetim nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit;
- Vërtetim nga Forcat e Armatosura;
- Urdhër mbrojtje apo urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje, lëshuar nga gjykata;
- Vërtetim nga Qendra Kombëtare e Shërbimit të Përkujdesit Shoqëror për viktimat e dhunës në familje;
- Vërtetim nga strukturat e shërbimit social, qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat e dhunës pranë njësive të qeverisjes vendore.
- Vetëdeklarim nëse individi/familja i përket minoritetit kombëtar Rom apo Egjiptian;
- Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për familjet e minoritetit kombëtar Rom;
- Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin;
- Vendim të organit kompetent si viktimë e orientimit seksual ose identitetit gjinor për ndividin që i përket komunitetit LGBTI;
- Dokument zyrtar të celebrimit dhe certifikatat personale, për efekt të llogaritjes së moshës, për çiftet e reja;
- Vërtetim me certifikatë familjare se individi i përket kategorisë vajzë- nënë

Për vërtetimin e kushteve ekonomike:

- Vërtetim i të ardhurave neto të familjes ose një deklaratë me shkrim nga aplikuesi për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre, të cilave, duhet t'i bashkëlidhen dokumente zyrtare që e vërtetojnë atë, përfshirë vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikuesit e të personave të tjerë madhorë të familjes, që janë në marrëdhënie pune. /vërtetim page për 3 muajt e fundit (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania).
- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe e Instituti i Sigurimeve Shoqërore për derdhjen e kontributeve për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania);
- Vërtetim nga Zyra e Ndhmës Ekonomike të bashkisë për anëtarët e familjes, të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi ndryshe (sigurohet nga Bashkia);
- Vërtetim për të ardhurat vjetore të biznesit për personat e vetëpunësuar/Pasqyra financiare për vitin kalendarik të shkuar për personat e vetëpunësuar e njehsuar nga Drejtoria Rajonale Tatimor
- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Punësimit për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania);
- Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për personat në pension (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania).

Aplikimi i kryer nga aplikuesi, duhet të depozitohet pranë zyrës së informacionit/ zyrës së protokollit të bashkisë Shijak .


Shënime: Individe apo familje që vetëdeklarohen me paaftësi apo pamundësi aksesit në rrjetin e komunikimeve elektronike mund të drejtohen pranë bashkisë Shijak apo njësive administrative me qëllim asistimin në kryerjen e aplikimit në portal.

Bashkia Shijak do të kujdeset që familjet dhe individët, të cilët nuk do të kualifikohen si përfitues në njërin program, do të kenë mundësi për të kaluar në një program tjetër strehimi social, kur plotësojnë kushtet ligjore.

Konceptoi : Drejtore Juridike A. Mehmeti

SEKRETAR I PERGJITHSHEM

Tauland Xheraj

A circular official stamp of the Municipality of Shijak is visible. The text around the perimeter of the stamp reads "REPUBLIKA E SHqipërisë" at the top and "BASHKIA SHIJAK" at the bottom. In the center of the stamp is a smaller emblem. A handwritten signature in black ink is written over the stamp.